



Balkan Sunflowers
Volunteers for Social Reconstruction



VOICE OF ROMA,
ASHKALI AND EGYPTIANS



KAAD
Kosovo Agency for
Advocacy and Development



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO



Health For All



RAD
Center
Roma & Ashkali Documentation Center

6 Nëntor 2014

Z. Hashim Thaçi
Kryeministër
Republika e Kosovës

I nderuar Kryeministër,

Udhëheqësit e “Platformës së OJQ-ve që merren me qështjet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas” të nënshkruar më poshtë, (nga tani e tutje do të përmenden si “Platforma”), dëshirojnë të shprehin brengën e tyre për rritjen e fundit në migrim të qytetarëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Kërkojmë përgjigje të menjëhershme nga Qeveria e Kosovës.

Sipas raporteve që janë mbledhur nga anëtarët e Platformës, më tepër se 360 familje Rome, Ashkali dhe Egjiptase (që shkon deri në 1700 individë) kanë migruar gjatë disa muajve të fundit nga Kosova, për të kërkuar një të ardhme më të mirë në shtetet e Europës Perendimore. Ky është një trend në vazhdim, me familje të reja duke e përcjellur këtë ritë çdo javë.

Arsyet e këtij fenomeni janë të shumtë, duke përfshirë faktorët ekonomik dhe social. Më 2009, Qeveria e Kosovës ka paraqitur Plan Veprimin për implementimin e “Strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Republikën e Kosovës” që është aprovuar më 2008 me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së këtyre qytetarëve, krahas aspekteve tjera, ekonomike, politike dhe edukative. Mirëpo, shumica e veprimeve të parapara në këtë strategji të Qeverisë së Kosovës, ose janë implementuar minimalisht ose nuk janë implementuar aspak. Prandaj, situata mbetet e pandryshuar për shumicën e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve.

Duke marrë parasysh seriozitetin e situatës së lartpërmendur, ju ftojme që të merrni masa të menjëhershme:

- Investoni në implementimin e duhur të Strategjisë për Integrim, veqanërisht kur është në pyetje krijimi i mundësive të punësimit, dhe gëzimit më të lartë të drejtave të njeriut;
- Implementoni një kampanje informuese të Qeverisë së Kosovës për të informuar njerëzit për rrezikun e migrimit ilegal dhe trafikimin me qenje njerëzore;



- Themeloni një Ekip Detyre me institucione dhe OJQ relevante që merren me qështjet e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve që të marrin parasysh krizën e lartpërmendur sociale dhe të propozojnë veprime më konkrete.

Ju falemnderit për konsideratën

Sinqerisht,

Platforma e OJQ-vë që merren me qështjet e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve në Kosovë.

Muhamet Arifi, Balkan Sunflowers

Adrian Zeqiri, European Centre for Minority Issues Kosovo

Gëzim Hoti, Health For All

Bashkim Ibishi, Kosovo Agency for Advocacy and Development

Bekim Syla, Roma, Ashkali Documentation Centre

Isak Skenderai, Voice of Roma, Ashkali and Egyptians

Kopjet elektronike për:

Ambasadën e Zvicrës në Kosovë
Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë
Ambasadën e Hungarisë në Kosovë
Ambasadën e Francës në Kosovë
Ambasadorin e Missionit të OSBE-së në Kosovë
Zyren e BE-së në Kosovë
Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
Zyren e Qeverisjes së Mirë